



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 19 shtator 2024  
Nr. ref.:RK2523/24

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI83/24**

Parashtrues

**H.P.G. Sh.p.k**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-22-0707] të 16 nëntorit 2023, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga subjekti (personi) juridik H.P.G. Sh.p.k, me seli në Pejë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Iliriana Osmani-Serreqi, avokate nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [AC-I-22-0707] të 16 nëntorit 2023 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DhPGjS-së).
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 19 dhjetor 2023.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartcekur të Kolegjit të Apelit, nëpërmjet së cilit parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksi dhe Palët e Autorizuara], në ndërlidhje me paragrafin 4 të nenit 21 të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 5 prill 2024, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 15 prill 2024, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin [GJR. KI83/24] caktoi gjyqtarin Radomir Laban, gjyqtar raportues dhe me Vendimin [KSH. KI83/24] caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).
8. Më 29 prill 2024, Gjykata e njoftoi përfaqësuesen e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: DhPGjS), nga e cila kërkoi dorëzimin e fletëkthesës si dëshmi e pranimit të aktgjykimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës.
9. Më 8 maj 2024, DhPGjS dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën, nga e cila vërtetohet se parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar aktgjykimi i kontestuar, më 19 dhjetor 2023.
10. Më 4 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri/me shumicë votash i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve të rastit**

11. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës parashtron për herë të dytë kërkesë në Gjykatë. Kërkesa e parë ishte regjistruar në Gjykatë me numër [KI217/13](#), nëpërmjet së cilës parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar procedurat për refuzimin e lëshimit të urdhrit paraparak gjyqësor, gjegjësisht të masës së përkohshme për parandalimin e



shitjes së *Ndërmarrjes së Re Bankkos Pejë Sh.p.k.*, nëpërmjet valës së 56 të privatizimit, për të cilën parashtruesi i kërkesës kishte ofertuar me një çmim të caktuar. Parashtruesi i kërkesës, kundër vendimeve të kolegjeve të DhPGjS-së, më 27 nëntor 2013 e parashtrroi kërkesën [KI217/13](#), në Gjykatën Kushtetuese, e cila ishte shpallur e papranueshme si qartazi e pabazuar, nëpërmjet Aktvendimit të 23 shtatorit 2014, me arsyetimin se e njëjta në thelb ngrenë çështje të “shkallës së katërt”. Parashtruesi i kërkesës thekson se vendimet e DhPGjS-së, që ndërlidhen me trajtimin e urdhrit paraparak gjyqësor (masën e përkohshme), nuk janë objekt shqyrtimi në kërkesën e tanishme KI83/24, por vetëm aspektet e shqyrtimit të padisë nga kolegjet e DhPGjS-së.

12. Më 18 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në DhPGjS, nëpërmjet së cilës kërkoi (i) anulimin e Vendimit [Ref. BD-51/16] të 21 marsit 2013 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, dhe (ii) të detyrohet AKP për të lidhur kontratë me parashtruesin e kërkesës për shitjen e asetit të saj, përkatësisht të *Ndërmarrjes së Re Bankkos Pejë Sh.p.k.*
13. Më 7 nëntor 2017, AKP-ja, në cilësi të palës së paditur, parashtrroi përgjigje në padi, nëpërmjet së cilës theksoi se më 11 prill 2013 ia kishte kthyer parashtruesit të kërkesës vlerën e depozituar prej dyqind mijë (200.000) euro.
14. Më 12 dhjetor 2017, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur komente ndaj përgjigjes në padi, duke argumentuar se vendimi për anulimin e tenderit për blerjen e asetit (*Ndërmarrjes së Re Bankkos Pejë Sh.p.k.*), ka qenë arbitrar dhe i pambështetur në kriteret të përcaktuara për vlerësime apo me ndonjë standard të çmimeve të ofertuara. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës ia kishte paraqitur AKP-së një raport të saj, për shitjen e aseteve në Komunën e Pejës për qëllime të krahasimit të çmimeve, përfshirë edhe fabrikat e privatizuara për të cilat parashtruesi i kërkesës ka theksuar se në të shumtën e rasteve kanë qenë shumë më të ulëta se çmimi i ofruar nga kompania HPG Sh.p.k.
15. Më 21 dhjetor 2017, AKP-ja parashtrroi kundërpërgjigje në përgjigjen e parashtruesit të kërkesës.
16. Më 28 dhjetor 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi komente pranë Kolegjit të specializuar të DhPGjS-së, ndaj përgjigjes së AKP-së.
17. Më 12 janar 2018, AKP-ja ka dorëzuar një parashtrësë si plotësim të kundërpërgjigjes, duke pohuar se Bordi i AKP-së në përputhje me autorizimet ligjore të Ligjit për AKP-në, dhe në mbështetje të nenit 17.1 të Rregullave të aplikueshme të tenderit, ka anuluar tenderin për asetet e saj (*Ndërmarrjen e Re Bankkos Pejë Sh.p.k.*), me arsyetimin se: “*nuk ka asnjë bazë ligjore të kontestohet ky vendim*”. Në mbështetje të pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar dy vendime të Kolegjit të Apelit pranë Kolegjit të specializuar të DhPGjS-së, që ndërlidhen me AKP-në, për të cilat i njëjti pretendon se Kolegji i Apelit kishte vendosur ndryshe kur kishte anuluar tenderët dhe krejtësisht ndryshe në rastin e tij.
18. Më 15 nëntor 2022, Kolegji i specializuar i DhPGjS-së mbajti seancë dëgjimore, me qëllim të dëgjimit të palëve ndërgjyqëse.
19. Më 5 dhjetor 2022, Kolegji i specializuar i DhPGjS-së, nxori Aktgjykimin [C-I-13-0015] nëpërmjet të cilit: (i) refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës, nëpërmjet së cilës ka kërkuar (i) anulimin e Vendimit [Ref. BD-51/16] të 21 marsit 2013 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së dhe (ii) që të detyrohet AKP të lidhë kontratë me parashtruesin e kërkesës për shitjen e asetit të saj, përkatësisht të *Ndërmarrjes së Re Bankkos Pejë Sh.p.k.*

20. Në arsyetimin e aktgjykimit, theksohet se: *“Nuk është kontestuese se paditësi për blerjen e objektit që përfshin sipërfaqen prej 2539 m2, ka ofertuar prej 564.40 € për m2. Kontestuese, sipas dy palëve është çmimi i ofertuar për blerjen e asetit kontraktues. Derisa paditësi ka ofruar çmimin e arsyeshëm për blerjen e asetit për m2, AKP në anën tjetër e kundërshton me arsyetimin se çmimi i ofruar është i një vlere shumë të ulët dhe nuk i përket çmimit të tregut për atë zonë afariste. Nisur nga këto dhe nga provat e analizuara në shkresat lëndës, Kolegji i vlerëson se nuk qëndron pretendimi i paditësit lidhur me krahasimet me njësitë e tjera të shitura, shitjet e të cilave i ka aprovuar Bordi i Drejtorëve, meqë këto shitje kanë ndodhur në vende dhe kohë të ndryshme dhe me karakteristika të ndryshme, të cilat e bëjnë të dallohet një aset nga tjetri, andaj një krahasim i tillë i paditësit nuk është i bazuar. Gjykata gjithashtu nuk gjen që procedura ka shkelur ligjin mbi detyrimet. Në fakt, e paditura është e lirë për të themeluar kushtet për tenderin që ofron për publikun dhe paditësi që në fillim i ka pranuar kushtet. Rregullat që e paditura zgjedh për t'i vendosur nuk janë ligje; por dispozita kontraktuale që i përkasin procedurës së tenderit. [...]. Pretendimi tjetër i paditësit referuar rastit AC-I-17-0245, të dt. 22 gusht 2019, se Kolegji i Apelit ka shpreh qëndrimin se arsytet e anulimit në vendim duhet të shprehen saktë pasi që çdo rast i ka specifikat e veta, gjykata ia përkujton paditësit se tek rasti AC-I-17-0245, i njëjti person fizik ishte shpallur dy herë radhazi nga AKP-ja si ofertuesi më i lartë në dy shitje të njëpasnjëshme për një aset të tenderuar dhe se dy herë AKP-ja kishte refuzuar shitjen për asetin në fjalë. Prandaj, referimi i paditësit i bërë këtij rasti, nuk përkon me rastin që është objekt i këtij gjykimi, meqë paditësi ka ofertuar vetëm një herë dhe siç thamë më lartë secili rast i ka specifikat e veta”.*
21. Më 28 dhjetor 2022, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DhPGJS-së, për shkak të: (i) shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, sipas nenit 182.2 të LPK-së, si dhe nenit 9.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me përmbajtjen e aktgjykimit; (ii) vërtetimit të gabuar/ mos vërtetimit të duhur të gjendjes së fakteve; si dhe (iii) zbatimit të gabuar të ligjit material.
22. Më 13 shkurt 2023, AKP, në cilësi të palës së paditur, pranë Kolegjit të Apelit të DhPGJS-së dorëzoi përgjigje në ankesë, nëpërmjet së cilës i kundërshtoi të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës, si të pambështetura në ligj dhe kërkoi vërtetimin në tërësi të Aktgjykimit [C-I-13-0015] të 15 dhjetorit 2022 të Kolegjit të specializuar të DhPGJS-së.
23. Më 16 nëntor 2023, Kolegji i Apelit i DhPGJS-së, duke vendosur për ankesën e parashtruesit të kërkesës, nxori Aktgjykimin [AC-I-22-0707], nëpërmjet të cilit (i) refuzoi ankesën e tij dhe (ii) vërtetoi në tërësi Aktgjykimin [C-I-13-0015] e 5 dhjetorit 2022 të Kolegjit të specializuar të DhPGJS-së. Në arsyetimin e aktgjykimit, Kolegji i Apelit ndër të tjera arsyetoi: *“[...] paditësi ishte njoftuar me Rregullat e Tenderit, përfshirë anulimin e mundshëm të tenderit. [...] Kolegji i Apelit thekson se gjykata nuk është e autorizuar me ndonjë dispozitë ligjore ta obligoj AKP-në, që të nënshkruaj kontratën (siç kërkohet nga paditësi), sepse AKP-ja është organ i pavarur publik (neni 1.1 Ligji për AKP-në) dhe prandaj është e pavarur të vendosë me kë të futet në marrëdhënie kontraktuale”.*
24. Duke iu përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Kolegji i Apelit i DhPGJS-së, theksoi: *“[...] për më tepër, paditësi as para Kolegjit të Shkallës së I-rë, as para Kolegjit të Apelit nuk ka ofruar asnjë provë me të cilin ai do të vërtetonte dëmin që atij i është shkaktuar. [...] Në procesin ritenderues paditësi si çdo ofertues tjetër ka mundësi të marrë pjesë në tender, dhe të ofroj një çmim tjetër, andaj në këtë rast nuk mund të konsiderohet se ka ndonjë kufizim apo ndonjë dëm të shkaktuar për paditësin”.*

## Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit, në ndërlidhje me Aktgjykimin e 5 dhjetorit 2022 të Kolegjit të specializuar të DhPGjS, shkel të drejtat e tij, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNj-së.

### *I. Pretendimet për shkelje të dispozitave të nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së*

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit është nxjerrë në kundërshtim me praktikën gjyqësore të këtij kolegji, duke vendosur në mënyrë diametralisht të kundërt për çështje faktike dhe juridike të njëjta. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i kontestuar, ndër të tjera, thekson se: "(i) Gjykata nuk është e autorizuar me ndonjë dispozitë ligjore të obligoj AKP-në të nënshkruaj Kontratën, sepse AKP-ja është organi i pavarur publik (neni 1.1 i AKP-së) dhe prandaj e pavarur vendos me kë futet në marrëdhënie kontraktuale; (ii) Bordi i AKP-së ka vendosur që të mos aprovoj shitjen për shkak të çmimit të lirë të ofruar. Sipas nenit 17, paragrafi 1 të Rregullave të tenderit: 'Bordi në diskrecionin e vet, mund ta shty dhe anuloj tenderin në çdo moment dhe për çfarëdo arsye'. Kjo dispozitë i lejon AKP-së që të anuloj tenderin; (iii) Paditësi ishte i njoftuar me Rregullat e tenderit, përfshirë anulimin e mundshëm të tenderit. Së pari, AKP-ja informoi paditësin se ai ofroi çmimin më të lartë dhe u shpall fitues i përkohshëm, dhe po ashtu ai është informuar se Bordi i AKP-së ose do të merr vendim mbi ofertuesin fitues, ose për anulimin e tenderit; (iv) Çdo pjesëmarrje në një procedurë tenderimi e ka të qartë, sipas nenit 17 të Rregullave të tenderit, se vetëm Bordi i AKP-së e ka autoritetin për aprovimin e një shitje. Ndërsa shitja mund të mos aprovohet edhe për shkak të çmimit të ultë të ofruar; (v) Prandaj përkundër pritshmërisë së paditësit, sidomos pas shpalljes së ofertës me çmimin më të lartë, anulimi i tenderit nuk mund të konsiderohet si dëm i shkaktuar pikërisht për shkak të nenit 17 të Rregullave të Tenderit, të cilat parashohin anulimin e shitjes për shkak të çmimit të ulët të ofruar; (vi) Është e qartë se paditësi ka nënshkruar rregullat e tenderit dhe kjo nënkupton se ai është pajtuar edhe për mundësinë e anulimit të tenderit".
27. Në mbështetje të pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës thirret në Aktgjykimin [AC-I-0245] e 22 gushtit 2019 dhe Aktgjykimin [AC-I-18-0395] e 22 tetorit 2021 të Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, me të cilin ishte vërtetuar Aktgjykimi [C-IV-14-5448] i 12 gushtit 2018 i Kolegjit të specializuar të DhPGjS-së. Parashtruesi i kërkesës thekson se në përbërje të Kolegjit të Apelit që kishte vendosur për padinë e tij, kanë marrë pjesë dy gjyqtarë të njëjtë që ishin pjesë e vendimmarrjes në nxjerrjen e Aktgjykimit [AC-I-18-0395], me të cilin vërtetohet se AKP-ja mund të detyrohet të lidhë kontratë me ofertuesit e tenderit. Në këtë kontekst, i njëjti mëton se anulimi i tenderit është bërë në mënyrë krejtësisht arbitrare dhe pa një analizë të mirëfilltë të bërë nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së. Në aspektet krahasimore, parashtruesi i kërkesës pretendon se AKP-ja nuk ka pasur një strukturë të përcaktuar qartë për vlerësim të çmimeve të tregut.

### *II. Pretendimet për shkelje të nenit 32, në ndërlidhje me nenin 54 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNj-së*

28. Pretendimet për shkeljen e kësaj të drejte të garantuar me Kushtetutë, parashtruesi i kërkesës i ndërton në formë të pyetjeve, duke theksuar: (i) Në çka konsiston e drejta për mbrojtje gjyqësore në rastet e tenderëve për privatizime, kundër AKP-së?; (ii) Cili qenka efekti i mjetit juridik që lejon kundërshtimin e vendimeve të Bordit të AKP-së me të cilat ky i fundit anulon tenderët?; dhe (iii) A mos është kjo një e drejtë kushtetuese

dhe ligjore e palës dhe veprim i gjykatës “sa për sy e faqe” nëse gjykata nuk paska autorizimin të urdhëroj palën në procedurë të veproj apo të korrigjojë gabimet qofshin ato me dashje apo pa dashje?

29. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon që të vërtetohet fakti që padia e tij nuk ka përmbajtur një kërkesë për kompensim dëmi, duke theksuar më tej se: “një arsyetim i tillë në përmbajtje të aktgjykimit të kontestuar mund të kuptohet ose si shqyrtim i pa vëmendshëm i kërkesëpadisë në procedurën pranë gjykatës ose si tendencë që, përmes kërkesave të paqena në kërkesëpadi, pozita e paditësit dhe fuqia provuese e provave të dorëzuara të paraqitet, apriori e mangët apo e dobët, dhe në anën tjetër të anashkalohet, ashtu siç ka ndodhur [...]”. Në këtë kontekst, parashtruesi kërkon që Gjykata: (i) TË DEKLAROJË TË PRANUESHME kërkesën e parashtruesit të kërkesës H.P.G. Sh.p.k, me seli në Pejë; (ii) TË KONSTATOJË SE Aktgjykimi [AC-I-22-0707] i 16 nëntorit 2023 i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës është marr në shkelje të nenit 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (iii) Të kthejë Aktgjykimin AC-I-22-0707 e 16 nëntorit 2023 për rivendosje në pajtim me aktgjykimin e kësaj Gjykate.

## Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

### KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

#### Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

#### Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.

#### Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

### KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

#### Neni 6

(E Drejta për një proces të rregullt)

1. “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga

*gjkata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.  
[...]*

Neni 13

(E drejta për zgjidhje efektive)

*“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”*

## **LIGJI Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

Neni 1

Themelimi dhe statusi ligjor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit

*1. “Agjencia Kosovare e Privatizimit (më tej “Agjencia”) është organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj; si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.  
[...]*

Neni 30

Paditë gjyqësore kundër Agjencisë

*1. “Dhoma e Veçantë ka juridiksion ekskluziv për të gjitha paditë kundër Agjencisë.  
2. Dhoma e Veçantë nuk do të pranojë asnjë padi kundër Agjencisë përveç nëse pala paditëse dorëzon dëshminë se e ka njoftuar kryesuesin e Bordit për dorëzimin e një padie të tillë së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para dorëzimit të saj. Me kërkesën e Agjencisë Dhoma e Veçantë mund të pezullojë hapjen e procedurës së padisë që është bërë kundër Agjencisë për një afat i cili nuk mund t'i kalojë gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e pranimit të padisë së tillë për të mundësuar një zgjidhje miqësore”.*

### **Pranueshmëria e kërkesës**

30. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.  
[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

[...]

32. Gjykata, gjithashtu, shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet: 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)



*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkoj nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48  
(Saktësimi i kërkesës)

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
(Afati)

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.*

33. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se: (i) parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar në kuptim të paragrafit (7) të nenit 113 të Kushtetutës; (ii) i njëjti konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [AC-I-22-0707] të 16 nëntorit 2023 të Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së; (iii) ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj; (iv) ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, ashtu siç kërkohet me dispozitat e nenit 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit dhe; (v) kërkesën e ka dorëzuar në pajtim me kërkesat e nenit 49 (Afatet) të Ligjit.
34. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në nënregullin (2) të rregullit 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 34  
(Kriteret e pranueshmërisë)

[...]

*“2. Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.*

[...]

35. Bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GjEDNj), por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr.



6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, [Kemmake kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii).

36. Siç është theksuar më lart, nëpërmjet kërkesës së tij, parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [AC-I-22-0707] të 16 nëntorit 2023 të Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, në ndërlidhje me Aktgjykimin e 5 dhjetorit 2022 të Kolegjit të specializuar të DhPGjS-së, duke pretenduar shkeljen e të drejtave të tij, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-se, nenin 32 dhe 54 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 13 të KEDNj-së.
37. Nga shkresat e lëndës, dhe nga mënyra se si janë argumentuar pretendimet në kërkesë, Gjykata vëren se esenca e ankesës që ngërthen kjo kërkesë e parashtruesit të kërkesës, ka të bëjë me moskonsistencën e praktikës gjyqësore të Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, ku sipas parashtruesit të kërkesës ky i fundit në dy raste tjera kishte vendosur ndryshe në rrethana të njëjta faktike dhe juridike, duke pretenduar në këtë kuptim shkeljen e të drejtës së garantuar me dispozitat e nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së.
38. Andaj, në vazhdim, Gjykata do të analizojë këtë pretendim thelbësor të parashtruesit të kërkesës në pajtueshmëri me standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

## **I. Përkitazi me pretendimet për moskonsistencë të praktikës gjyqësore nga ana e Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së**

### *a) Parimet e përgjithshme*

39. Përkitazi me parimet themelore që ndërlidhen me konsistencën e praktikës gjyqësore, Gjykata rikujton se praktika gjyqësore e GjEDNj-së ka rezultuar në katër parime themelore që e karakterizojnë analizën lidhur me konsistencën e praktikës gjyqësore, dhe atë si në vijim: (i) siguria juridike; (ii) nuk ka një të drejtë të fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore; (iii) divergjenca nuk është domosdoshmërisht në kundërshtim me KEDNj-në; dhe (iv) përjashtimi i arbitraritetit të dukshëm.
40. Duke iu referuar parimeve të përcaktuara më lart, Gjykata më tej thekson se GjEDNj-ja përdor tri kriteret themelore për të përcaktuar nëse një divergjencë e pretenduar përbën shkelje të nenit 6.1 të KEDNj-së, i pari (i), nëse divergjencat në praktikën gjyqësore janë “të thella dhe afatgjata” i dyti (ii), nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe i treti (iii), nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti (në këtë kontekst, shih rastet e GjEDNj-së, [Beian kundër Rumanisë](#), nr. 30658/05, Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37 -39; [Famullia Greko-Katolike e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), nr. 76943/11, Aktgjykimi i 29 nëntorit 2016,



paragrafët 116 - 135; [Jordan Jordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë](#), nr. 23530/02, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50; [Nejdet Sahin i Perihan Sahin kundër Turqisë](#), nr. 13279/05, Aktgjykimi i 20 tetorit 2011, paragrafi 53; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, [KI175/20](#), Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendimi i 26 marsit 2021, paragrafi 60).

41. GjEDNj, në lidhje me këtë, ka konstatuar se mundësia e vendimeve kontradiktore gjyqësore është një tipar i qenësishëm i çdo sistemi gjyqësor i cili bazohet në një rrjet të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit me autoritet mbi fushën e juridiksionit territorial të tyre. Divergjencat e tilla mund të paraqiten gjithashtu brenda të së njëjtës gjykatë. Kjo, në vetvete, nuk mund të konsiderohet në kundërshtim me KEDNj-në (shih, rastet e GjEDNj-së, [Nejdet Sahin i Perihan Sahin kundër Turqisë](#), cituar më lart, paragrafi 51; [Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë](#) dhe 63 (gjashtëdhjetë e tri) kërkesa tjera, Aktgjykim i 10 majit 2012, paragrafi 34; [Santo Pinto kundër Portugalisë](#), nr. 39005/04, Aktgjykim i 20 majit 2008, paragrafi 41; dhe [Famullia Greko-Katolike e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), paragrafi 122; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, [KI175/20](#), Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendimi i 26 marsit 2021, paragrafi 57).
42. GjEDNj ka theksuar vazhdimisht se, përveç rasteve të arbitraritetit të dukshëm, nuk është detyrë e saj të vë në pikëpyetje interpretimin e ligjit vendas nga ana e gjykatave vendore (shih, për shembull, rastet e GjEDNj-së [Adamsons kundër Letonisë](#), nr. 3669/03, Aktgjykim i 24 qershorit 2008, paragrafi 118; dhe [Nejdet Sahin i Perihan Sahin kundër Turqisë](#), cituar më lart, paragrafi 50) dhe në parim, nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave vendore, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave.
43. Gjykata, në këtë kontekst, tashmë ka një praktikë gjyqësore të konsoliduar për sa i përket çështjeve që ndërlidhen me shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë, si rezultat i praktikës gjyqësore jokonsistente, e cila cenon drejtpërdrejt parimin e sigurisë juridike. (shih, rastet e Gjykatës [KI35/18](#), me parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, dhe [KI87/18](#), me parashtrues *IF Skadeforsikring*, ku Gjykata konstatoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, si rezultat i divergjencës në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, po ashtu shih edhe rastet e Gjykatës, [KI74/19](#), [KI111/19](#), [KI09/20](#) dhe [KI188/20](#), me parashtrues *Suva Rechtsabteilung*, Aktgjykimet e 28 prillit 2021, në të cilat Gjykata në trajtimin e pretendimeve për divergjencë në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, nuk kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së.

*b) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret*

44. Në vijim, Gjykata do të aplikojë parimet e elaboruara më lart në rrethanat e rastit konkret, duke aplikuar kriteret mbi bazën e të cilave Gjykata dhe GjEDNj trajton çështjet e divergjencës përkitazi me praktikën gjyqësore, duke filluar me vlerësimin nëse në rrethanat e rastit konkret, (i) divergjencat e pretenduara në praktikën gjyqësore janë “të thella dhe afatgjata”; dhe nëse ky është rasti, (ii) ekzistimin e mekanizmave të aftë për të zgjidhur divergjencën përkatëse; dhe (iii) vlerësimin nëse këta mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti në rrethanat e rastit konkret.
45. Pretendimi thelbësor i parashtruesit të kërkesës konsiston në faktin se Kolegji i Apelit i DhPGjS-së ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese, sepse ka vendosur standarde të ndryshme për raste me rrethana të njëjta faktike dhe juridike, duke treguar jokonsistencë në aktgjykimet e saj. Në mbështetje të këtyre pretendimeve parashtruesi i kërkesës ia ka bashkëngjitur kërkesës dy aktgjykime të Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së AC-I-0245, të 22 gushtit 2019 dhe AC-I-18-0395 të 22 tetorit 2021.



46. Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së dhe të vetë Gjykatës, si rregull thekson se nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse ato merren në procedura dukshëm të ngjashme, pasi që pavarësia e tyre duhet të respektohet (shih, rastin e GjEDNj-së [Adamsons kundër Letonisë](#), cituar më lart, paragrafi 118, shih po ashtu rastet e Gjykatës [KI87/18](#) dhe [KI35/18](#), të cituara më lart, dhe po ashtu rastin [KI102/22](#), me parashtrues: *Faton Aliu*, Aktvendimi i 5 prillit 2023, paragrafi 48).
47. Gjykata vazhdon të theksojë se parashtruesit e kërkesës lidhur me pretendimet për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore të tyre si rezultat i divergjencave në praktikë gjyqësore, duhet t'i paraqesin Gjykatës argumente përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat, duke rezultuar në vendime kundërthënëse në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së (shih, rastin [KI35/18](#), cituar më lart, paragrafi 76, dhe [KI102/22](#), cituar më lart, paragrafi 49).
48. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet jurisprudencës së GjEDNj-së, e cila përcakton se *"... është përgjegjësi e autoriteteve vendore për të organizuar sistemin juridik në atë mënyrë që të shmangën vendimet kundërthënëse, sidomos një kërkesë e tillë është më e fuqishme kur kundërthëniet e praktikës gjyqësore nuk janë një incident (rast) i izoluar, por kjo jokonsistencë mund të afektojë një numër më të madh të personave që paraqiten në gjykatë* (shih, rastin e GjEDNj, [Famullia Greko-Katolike e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 129).
49. Gjykata, duke iu rikthyer pretendimeve të parashtruesit të kërkesës rikujton praktikën e saj, ku kishte mbrojtur qëndrimin se nuk mund të konstatohet jokonsistencë në praktikën gjyqësore të instancës më të lartë gjyqësore, në këtë rast në praktikën e Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, në krahasimin e vetëm dy (2) aktgjykimeve të këtij të fundit, me rastin e parashtruesit të kërkesës, edhe nëse te këto vendime mund të përmbajnë çështje të njëjta faktike dhe juridike. Në një rrethanë të tillë, ku parashtruesit e kërkesës i referohen vetëm një apo dy vendimeve, të cilat përmbajnë konstatim dhe përfundim ndryshe nga vendimi i nxjerrë në rastin e tyre, Gjykata nuk kishte konstatuar shkelje të dispozitave të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së, përkatësisht shkelje të parimit të sigurisë juridike, si rezultat i praktikës gjyqësore jokonsistente (shih, rastet e Gjykatës: [KI29/17](#), parashtrues *Adem Zhegrova*, Aktvendimi i 5 shtatorit 2017, paragrafi 53; [KI42/17](#), parashtrues *Kushtrim Ibraj*, Aktvendimi i 5 dhjetorit 2017, paragrafi 44; [KI107/19](#), parashtrues *Gafurr Bytyçi*, Aktvendimi i 11 marsit 2020, paragrafi 76; dhe [KI139/19](#), parashtrues *Riad Bejtullahu*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2020, paragrafi 58, dhe [KI102/22](#), cituar më lart, paragrafi 59).
50. Duke rikujtuar detyrimin e përcaktuar nëpërmjet praktikës gjyqësore të Gjykatës që parashtruesit e kërkesës duhet t'i paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmëritë faktike dhe juridike të rasteve për të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërthënëse, Gjykata vëren se përveç dorëzimit të një apo dy rasteve të vetme, dhe që i referohet rrethanave faktike dhe juridike të ngjashme, parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur që Gjykatës t'i paraqesë argumente shtesë, apo raste tjera që dëshmojnë moskonsistencën në vendimmarrje nga ana e Kolegjit të Apelit i DhPGjS-së, për çështje tërësisht të njëjta faktike dhe juridike.



51. Në këtë kontekst, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme të analizojë rrethanat faktike dhe juridike të rasteve të bashkëngjitura, nëpërmjet një analize krahasuese, sepse tashmë ka praktikë të konsoliduar gjyqësore, të mbështetur në parimet e përcaktuara nga GjEDNj-ja, në lidhje me jokonsistencën, e cila përcakton se nuk është e mundur të konstatohet ekzistenca e pasigurisë juridike në praktikën gjyqësore të instancës më të lartë të gjyqësorit të rregullt, gjegjësisht të Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, duke u thirrur vetëm në dy vendime, në këtë rast në dy aktgjykime të këtij të fundit, për më tepër që koha e vendimmarrjes së tyre, nuk i përgjigjet kriterit që kërkon “*dallime të thella dhe afatgjata*”, sepse edhe nëse do të konfirmohej kundërthënia në vendimmarrje ajo për përuar kohore prej tri (3) viteve, e dy (2) muajve (shih, në mënyrë analoge rastin e Gjykatës [KI29/17](#), cituar më lart, paragrafi 53, dhe [KI102/22](#), cituar më lart, paragrafi 62).
52. Për më tepër, bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata ka vërejtur se aktgjykimi [AC-I-0245] i 22 gushtit 2019 i Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së ishte objekt vlerësimi edhe pranë Kolegjit të specializuar të DhPGjS-së, i cili, mes tjerash, theksoi se: “*Pretendimi tjetër i paditësit referuar rastit AC-I-17-0245, të dt. 22 gusht 2019, se Kolegji i Apelit ka shpreh qëndrimin se arsyet e anulimit në vendim duhet të shprehen saktë pasi që çdo rast i ka specifikat e veta, gjykata ia përkuqton paditësit se tek rasti AC-I-17-0245, i njëjti person fizik ishte shpallur dy herë radhazi nga AKP-ja, si ofertuesi më i lartë në dy shitje të njëpasnjëshme për një aset të tenderuar dhe se dy herë AKP-ja kishte refuzuar shitjen për asetin në fjalë. Prandaj referimi i paditësit i bërë këtij rasti, nuk përkon me rastin që është objekt i këtij gjykimi, meqë paditësi ka ofertuar vetëm një herë dhe siç thamë më lart, secili rast i ka specifikat e veta*”. Po ashtu, Gjykata vëren se edhe Kolegji i Apelit i DhPGjS-së ka adresuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me vendimet kundërthënës për çështje të njëjta faktike dhe juridike, duke theksuar se: “*Kolegji i Apelit konstaton se secili rast ka specifikat dhe rrethanat e veçanta, andaj ato konstatime të cilat thirret paditësi, nuk mund të jenë arsye dhe as bazë për të dhënë një rezultat tjetër lidhur me padinë ...*”.
53. Duke u bazuar në të lartcekurat, Gjykata konsideron se as numri i aktgjykimeve të pretenduara si kundërthënës, dhe as periudha kohore brenda së cilës janë nxjerrë këto aktgjykime, si dhe as mënyra se si Kolegji i Apelit i DhPGjS-së ka vlerësuar dhe trajtuar rastin e parashtruesit të kërkesës nuk krijojnë bazë të mjaftueshme për të arsyetuar pretendimin për shkelje të parimit të sigurisë juridike, si rrjedhojë e vendimeve kundërthënës të Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së (shih, rastin [KI29/17](#), cituar më lart, paragrafi 58, dhe [KI102/22](#), cituar më lart, paragrafi 63).
54. Gjykata, bazuar në standardet e evoluimit të praktikës gjyqësore, përsërit qëndrimin e saj se vendimmarrja e gjykatave të rregullta është dinamike, dhe ajo mund ndryshojë, duke iu përshtatur rrethanave të reja si dhe duke përmirësuar administrimin e drejtësisë. Është në diskrecionin dhe autoritetin e tyre për të vlerësuar dhe interpretuar të drejtën pozitive. Megjithatë edhe nga arsyetimi i instancave të DhPGjS-së lehtësisht kuptohet arsyet se ku dallojnë rastet në krahasim për nga rrethanat faktike dhe juridike.
55. Andaj, bazuar në të gjitha elaborimet e mësipërme, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me dispozitat e nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së, përkitazi me jokonsistencën e praktikës gjyqësore të Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, i përkasin kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj si të tilla në baza kushtetuese të njëjtat i shpallë qartazi të pabazuara.



## II. Përkitazi me pretendimet e tjera

56. Në vlerësimin e pretendimeve të tjera, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, pretendon edhe shkelje të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 të KEDNj-së. Gjykata përsërit se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së ose ndërlidhja e tyre me një nen tjetër të Kushtetutës nuk nënkupton me automatizëm edhe shkelje të neneve të tjera të Kushtetutës dhe KEDNj-së, nëse më tej nuk argumentohet dhe shtjellohet se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e tyre.
57. Gjykata vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj, parashtruesit e kërkesave duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; [KI166/20](#) parashtrues *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2020, paragrafi 52; [KI04/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).
58. Andaj sa më sipër, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen të neneve të lartcekura, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla në baza kushtetuese edhe këto pretendime duhet shpallur qartazi të pabazuara.

## Përfundime

59. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se: (I) pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së, për moskonsistencë në praktikën gjyqësore, i përkasin kategorisë së tretë (iii), të pretendimeve të “*pambështetura apo të paarsyetuara*”, andaj si të tilla, në baza kushtetuese të njëjtat shpallen qartazi të pabazuara; dhe (II) pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe 13 të KEDNj-së, i përkasin po ashtu kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj si të tilla, në baza kushtetuese të njëjtat po ashtu shpallen qartazi të pabazuara.
60. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, në pajtueshmëri me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, duhet shpallur e papranueshme si qartazi e pabazuar.

## PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 dhe 47 të Ligjit dhe nënregullin (2) të rregullit 34, si dhe rregullin 48 (1) b) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2024, njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Radomir Laban



  
Gresa Caka-Nimani